

STATUT

I shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar

B + M Project Albania Shpk.



Ne kete statut

- "Ligji" eshte Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", i ndryshuar;
- "Statuti" eshte Statuti i shoqerise;

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1. Sot, me 01.10.2018, ne, themeluesit, kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin "B + M Project Albania" SH.P.K.
2. Themeluesit e shoqerise jane:
 - a. Vincenzo Borrelli lindur ne Napoli, me 02maj 1957, mbajtes i dokumentit te identifikimit numer CA19470CD, leshuar nga Ministria e Brendshme e Republikes Italiane me date 04 shtator 2018 dhe i vlefshem deri me date 02maj 2029.
 - b. Alessandro Martinini i lindur ne Novara, me 18 qershor 1974, mbajtes i dokumentit te identifikimit numer AR5256458, leshuar nga Ministria e Brendshme e Republikes Italiane me date 02prill 2011 dhe i vlefshem deri me date 02prill 2021.

Neni 2

Objekti

1. Shoqeria do te kryeje aktivitetet si vijon: "Investime per pasuri te paluajtshme, tregtim i artikujve te ndryshem, sherbime konsulence, ne fushen e biznesit, menaxhimit, taksave etj. Importi, eksporti, shitja me shumice dhe pakice e produkteve tekstile, veshjeve te gjitha llojeve. Shitja me shumice dhe pakice e mallrave industriale dhe ushqimore. Importi, eksporti, shitja me shumice dhe pakice e pajisjeve elektrike, elektronike, lende te pare per industrine, materiale ndertimi e hidrosanitare, pajisje zyresh, kancelari, pjese kembimi auto e makineri te cdo lloji, pajisje teknologjike. Shitja, blerja, dhenia me qira, e pasurive te paluajtshme. Transport i mallrave dhe udhetareve brenda dhe jashte vendit. Menaxhimi i qendrave tregtare, bareve, restoranteve si dhe cdo aktiviteti tjeter me qellim rekreacioni, hotelerie dhe turizmi. Aktivitetit te blerjes dhe shitjes se aksioneve, operacione tregtare dhe financiare me banka, me persona juridike, fizike, shoqeria mund te jape garanci reale ne favour te treteve, te enteve publike, bankave, apo dhe ne favour te vete ortakeve, operacionet e kembimeve valutore, marrjen e huave nga institucionet financiare apo individet e ndryshem, operacione studimore ne fushen e turizmit

infrastruktura, energjise, shfrytezimit minerar, agriculture etj, te drejten e investimeve ne fusha te ndryshme, ne fushen e blerjes dhe shitjeve te pasurive te pa lujajtshme dhe te lujajtshme, mbledhjen dhe perpunimin e te dhenave per te trete, krijimin dhe drejtimin e te dhenave te çfaredolloj tipi, aktivitet per nderhyrje kreditore ne te gjitha format e parashikuara nga normativat perkatese, ndermjetesim ne blerjen dhe ne trajnimin e praktikave te financimit, leasing, hua, garancive, imobilare, praktika per kredi konsumi, per shlyerje kredish, asistencë per keshillime ekonomike dhe financiare, per studime te realizushme plane sipermarje dhe analize tregtare, formulimin, pershtratjen dhe egzaminimin per llogari se te treteve, te programeve financiare, te investimit apo zhvillim te perbashket gjithashtu aktivitetet kujdestarie per zhvillimin e projekteve ndermarese dhe çfaredo lloj forme iniciative te zhvillimit, organizim e sipermarjeve edhe per paraqitje kerkese per financim te çfaredo lloj forme iniciative te zhvillimit, organizimi sipermarjeve edhe per paraqitje kerkese per financim te çfaredolloj tipi sipas asaj qe eshte vendosur nga autoritetet vendore, kombetare dhe komunitare, zbatimin dhe drejtimin e proceseve outsourcing ne sektoret qe hyjne ne objektin e aktiviteteteve sociale. Si dhe çdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te Shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

2. Shoqeria do te kryejë çdo veprim me qellim marrjen e lejeve, autorizimeve, licencave dhe miratimeve te nevojshme per realizimin e veprimtarive te saj, per te cilat kerkohen keto dokumente administrative.

Neni 3 Kohezgjatja

1. Kohezgjatja e Shoqerise do te jete pa afat te caktuar. Ky afat mund te ndryshohet nje ose me shume here me vendim te asamblese se aksionareve.

Neni 4 Selia

1. Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: "Lagjia 1, Rruga Taulantia, Pallati Nr. 1000, Currila, Durres.

KREU II KAPITALI

Neni 5 Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 1.000,00 (nje mije) Leke. Ky kapital eshte i ndare ne 2 (dy) kuota nga 500 (peseqind) leke:
2. Ky kapital zoterohet nga ortakët ne masen 2 kuota:
 - Vincenzo Borrelli 50 (pese dhjete) % ose 1 (nje) kuota.
 - Alessandro Martinini 50 (pese dhjete) % ose 1 (nje) kuota
3. Te gjitha aksionet e shoqerise jane aksione te zakonshme. Asambleja e ortakëve, me vendim unanim, mund te vendose per emetimin e aksioneve te ndryshme nga ato te

zakonshmet. Vendimi per emetimin e aksioneve percakton sasine e aksioneve si dhe tagrat e tyre.



Neni 6

Regjistri i aksioneve

1. Shoqeria mban nje regjister te posaçem, ku regjistrohen te dhenat e zoteruesve te aksioneve te shoqerise, si: emri e mbiemri i aksionarit, apo emri i regjistruar, nese eshte person juridik, vlera nominale e aksionit, adresa e banimit apo zyra qendrore e aksionarit dhe data e kryerjes se regjistrimit.
2. Administratori eshte pergjegjes per mbajtjen e regjistrit te aksioneve te shoqerise e detyrohen te lejojne aksesin ne informacionet e regjistrit ndaj çdo aksionari. Informacioni i regjistrit te aksioneve duhet te publikohet ne faqen e shoqerise ne internet.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

1. Kuotat e kapitalit te zoteruara nga aksionaret dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:
 - a. kontributit ne kapitalin e shoqerise;
 - b. shitblerjes;
 - c. trashegimise;
 - d. dhurimit;
 - e. çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.
2. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, persa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
3. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie, por trashegimtarete aksionaret e tjere te shoqerise gezojne te drejten e parablerjes mbi aksionet e fituara me ane te trashigimnise.

Neni 8

Zmadhimi i Kapitalit Themeltar

1. Kapitali i regjistruar i shoqerise mund te zmadhohet duke emetuar aksione rishtazi, kundrejt kontributeve te reja ose nepermjet kalimit ne kapitalin baze te aktiveve te shoqerise.
2. Kur emetohen aksione te reja, keto aksione iu ofrohen aksionareve ekzistues perpara se t'u ofrohen aksionareve te rinj. Oferta qe ju behet aksionareve ekzistues duhet te pranohet brenda 20 ditesh pas publikimit ne QKB.
3. Asambleja e aksionareve mund te vendose qe zmadhimi i kapitalit te kryhet me emetim te aksioneve te reja, per t'u nenshkruar vetem nga aksionaret ekzistues. Zmadhimi i kufizuar i kapitalit mund te kryhet vetem me vendim unanim te te gjithë aksionareve.
4. Administratoret kane te drejten per te kryer, Brenda nje afati 5-vjeçar nga regjistrimi I shoqerise, zmadhim te kapitalit me emetim te aksioneve te reja, per nje vlere maksimale te percaktuar (kapitali autorizuar).Vlera e zmadhimeve te autorizuar nuk mund te jete



me e madhe se gjysma e kapitalit te regjistruar te shoqerise ne daten ne te cilen merret vendimi per zmadhimin e autorizuar.

5. Pas miratimit te bilancit te vitit paraardhes, Asambleja e Aksionareve mund te vendose ta zmadhoje kapitalin e regjistruar, duke kaluar ne kapitalin baze rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashperndara.
6. Asambleja e pergjithshme mund te emetoje obligacione, qe u garantojne zoteruesve te tyre te drejten per t'i konvertuar ne aksione apo te drejten e parablerjes se aksioneve, te cilat quhen obligacione te konvertueshme, si dhe obligacionet, qe u japin zoteruesve te drejten e marrjes pjese ne fitim, te cilat quhen obligacione me pjesemarrje ne fitim.

Organi administrativ perkates i njofton Qendres Kombetare te Biznesit, per regjistrim dhe publikim.

Neni 9

Zvogelimi i Kapitalit Themeltar

1. Kapitali i regjistruar i shoqerise mund te zvogelohet me vendim te Asamblese se Aksionareve.
2. Zvogelimi i kapitalit mund te realizohet nepermjet zvogelimit te vleres nominale te aksioneve dhe/ose anulim aksionesh, dhe formave te tjera te parashikuara nga ligji per shoqerite tregtare.

Neni 10

E drejta e votes

1. Çdo aksion i zakonshem i jep zoteruesit te tij te drejta vote ne raport proporcional me pjesen e kapitalit qe perfaqeson aksioni.
2. Ndalohet emetimi i aksioneve, te cilat i japin zoteruesit te tyre me shume te drejta vote, ne raport me pjesen e kapitalit, qe aksioni perfaqeson.


KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 11

Organi Vendimmarres

1. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.
2. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.
3. Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e meposhtme:
 - a. percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
 - b. ndryshimet e statutit;
 - c. emerimin e shkarkimin e administratoreve;
 - d. emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
 - e. percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;



- f. mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - h. zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
 - i. pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j. perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - k. riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
 - l. miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
 - m. çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.
4. Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.
 5. Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.
 6. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 12

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme


1. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
2. Ne rastin e njoftimit nepermjet postes elektronike mesazhi do te konsiderohet si i marre ne adresen elektronike qe secili nga aksionaret ka depozituar prane shoqerise dhe nuk mund t'i kundërshtohet asamblese parregullsia e njoftimit per shkak te mosmarrjes se mesazhit elektronik.
3. Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortakët jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

Neni 13

Kuorumi

1. Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortakët me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 75 per qind te kuotave.
2. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortakët qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.
3. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 14



Handwritten signature and a circled number 5.

Marrja e vendimeve

1. Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
2. Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si :
 - a. percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
 - b. emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
 - c. emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
 - d. percaktimin e shperblimeve
 - e. mbiqerqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - f. perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - g. miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;

Neni 15

Perjashtimi nga e drejta e votes

1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:
 - a. vleresimin e veprimtarise se tij;
 - b. shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
 - c. ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
 - d. dhenien ose jo te perfitimeve te reja.
2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 16

Administrimi

1. Asambleja e pergjithshme emerone nje person fizik si administrator te shoqerise.
2. Afati i emerimit, eshte 1 vit, me te drejte ripertesitjeje.
3. Emerimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.
4. Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. Çdo emerim i bere ne kundërshtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.
5. Themeluesit kane emeruar si Administrator te pare te shoqerise deri ne themelimin e shoqerise dhe realizimin e mbledhjes se pare te Asamblese se Pergjithshme:
 - a. Z. Alessandro Martinini i lindur ne Novara, me 18 qershor 1974, mbajtes i dokumentit te identifikimit numer AR5256458, leshuar nga Ministria e Brendshme e Republikës Italiane me date 02 prill 2011 dhe i vlefshem deri me date 02 prill 2021.



Neni 17

Kompetencat dhe kufizimet e Administratorit

1. Administratori ka te drejte e detyrohet te:
 - a. kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
 - b. perfaqesoje shoqerine tregtare;
 - c. kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
 - d. pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
 - e. krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
 - f. kryeje regjistrimet dhe dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit;
 - g. raportoje perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
 - h. kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.
 - i. te delegoje me akt te shkruar pjeserisht ose teresisht funksionet dhe kompetencat e tij tek persona te trete, fizike ose juridike.
2. Administratorieshte i detyruar te therrase Asamblene e Pergjitheshme, ne rastet kur:
 - a. sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
 - b. shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
 - c. shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
3. Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.
4. Procedurat per shkarkimin e administratorit jane ato te parashikuara nga Kodi i Punes se Republikes se Shqiperise. Keto procedura ndiqen nga Asambleja e Ortakeve perpara marrjes se vendimit per shkarkimin e administratorit.

Neni 18

Pergjegjesite e Administratorit

1. Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.
 2. Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale osesolidarisht sipas rastit pasojat perkatese.
- 
- 

3. Perveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
 - a. të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në teresi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - d. të parandalojë dhe menjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
 - e. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
4. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
5. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i demshperblejë shoqërisë dëm, qerrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vertetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kerkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjet ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
6. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i demshperblejë shoqërisë dëm e shkaktuar, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, kryen veprimet e mëposhtme:
 - a. u kthen ortakeve kontributet;
 - b. u paguan ortakeve interesa apo dividende;
 - c. u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - d. lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhet të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - e. jep kredi.
7. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit
8. Paditesit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe demshperblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblese nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 19

Perfundimi i detyrës së Administratorit

1. Detyra e Administratorit perfundon në rast se:
 - a. Mbaron afati për të cilin është emëruar në detyrë;
 - b. Shkarkohet nga detyra;
 - c. Personi ndodhet në gjendje pa aftësi paguese;

- d. Personi vuan apo mund te vuaje nga ç'rregullime mendore;
- e. Personi jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar shoqerine, ose
- f. Ka munguar ne detyre per me shume se gjashte muaj rradhazi pa lejen e Asamblese se Aksionareve.

KREU IV VITI FINANCIAR-EKSPERTET

Neni 20 Viti Financiar

1. Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 21 Ekspertet

1. Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjeter dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
2. Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

KREU V DIVIDENDET DHE KALIMI I FITIMEVE

Neni 22 Dividendet

1. Ne perfundim te vitit ushtrimor Asambleja e Aksionareve mund te deklaroje dividendet ne perputhje me te drejtat perkatese te aksionareve.
2. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe lidhen me aksionet, te gjithë dividendet deklarohen dhe paguhen ne perputhje me shumat e paguara per aksionet per te cilet paguhet dividendi.
3. Asnje dividend ose pagese ne para qe lidhet me nje aksion nuk prodhon interesa kundrejt shoqerise nese nje gje e tille nuk parashikohet ne tedrejtat e aksionit.
4. Çdo dividend qe nuk eshte kerkuar te paguhet Brenda dymbëdhjete vjeteve nga data e maturimit, ne rast se vendoset nga Asambleja e Aksionareve, do te perfitohet nga shoqeria e cila nuk do te jete me e detyruar qe ta paguaje ate.

Neni 23 Kalimi i fitimeve ne kapitalin themeltar

1. Asambleja e Aksionareve mund te vendose te kaloje ne kapitalin themeltar te Shoqerise, fitimet e pashperndara te cilat nuk do te perdoren per te paguar dividendet.

KREU VI PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Neni 24 Prishja dhe likuidimi

- 1- Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :
 - a. kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
 - b. me vendim te Asamblese se Ortakeve;
 - c. me hapjen e procedurave te falimentimit;
 - d. nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare teBiznesit”;
 - e. me vendim te gjykates;
- 2- Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.
- 3- Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise pagueuse, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.
- 4- Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.
- 5- Nese Ortaket nuk merrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 25 Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja

- 1- Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vednimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare.”

Neni 26 Baza Ligjore

- 1- Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2- Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 27 Mosmarreshjet

- 1- Per mosmarreshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 28
Dispozita Kalimtare

- 1- Administratori i shoqerise i emeruar sipas nenit 16.pika 5 te ketij statuti ngarkohet dhe autorizohet per kryerjen e te gjitha veprimeve te nevojshme per regjistrimin e shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit.



ORTAKET
E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
B + M Project Albania Shpk.

Borrell Orupo



MARTININI ALESSANDRO

Martinini Alessand

0

STATUTO DELLA SOCIETA' A RESPONSABILITA' LIMITATA "SRL"

In questo statuto

- "Legge" è la legge n. 9901, dt. 14.04.2008 "Trader and Companies", come modificato;
- "Statuto" è lo Statuto della Società;

CAPITOLO I COSTITUZIONE, NOME, OGGETTO, DURATA, SEDE

Articolo 1

Data di costituzione, nome e fondatori

1. Oggi, il 01.10.2018, i soci costituiscono una società a responsabilità limitata con il nome "B + M Project Albania" SH.P.K.
2. I soci dell'azienda sono:
 - a. Vincenzo Borrelli nato a Napoli il 2 maggio 1957, il titolare del documento numero di identificazione CA19470CD, rilasciato dal Ministero degli Interni della Repubblica Italiana in data 4 settembre 2018 e valido fino alla data 2 maggio 2029.
 - b. Alessandro Martinini nato a Galliate il 19 giugno 1974, titolare del documento numero di identificazione AR5256458, rilasciato dal Comune di Novara in data 02 aprile 2011 e valido fino alla data del 01 aprile 2021.

Articolo 2

Oggetto

1. La società svolge le seguenti attività:

